

VENDIM
Nr.554, datë 16.8.2006

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.241, DATË 20.4.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR TRI URAT-ÇARSHOVË, NË TERRITORIN E QARKUT TË
PËRMETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.241, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:
 - a) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:
“3/1 Pronari i pasurisë së paluajtshme z.Jani Sotir Xhallo, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 373 m² tokë bujqësore, e vlerësuar me 700 lekë/m², e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 261 100 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh.”.
 - b) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:
“4/1 Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 261 100 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
Shpenzimet procedurale, në shumën prej 112 500 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.”.
2. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 1.10.2006.
3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I KANALIT TË UJËRAVE TË
BARDHA GJATË SEGMENTIT RRUGOR TRI URAT ÇARSHOVË

Nr.	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmini në lekë për m ²	Vlera në lekë
1.	Jani Sotir Xhallo	Nr.163/26	1356	373 m ²	700	261 100

Vlera totale e këtij shpronësimi është 261 100 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind lekë).